

E DREJTA PËR INFORMIM

Rritet transparenca proaktive e autoriteteve publike, publikohen Indekset për vitin 2025

Zyra e Komisionerit realizoi për të gjashtin vit radhazi procesin e monitorimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike në Republikën e Shqipërisë. [Monitorimi për vitin 2025](#) ka përfshirë 367 autoritete publike qendrore dhe të varësisë, institucione të pavarura, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të sistemit të drejtësisë, institucione të arsimit të lartë, urdhra profesionale, si dhe shoqëri tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve.

Transparenca proaktive nënkupton publikimin e rregullt dhe të përditësuar të informacionit nga autoritetet publike, duke u mundësuar qytetarëve ndjekjen e veprimtarisë institucionale. Publikimi sistematik i informacionit forcon përgjegjshmërinë, besueshmërinë dhe llogaridhënien e institucioneve ndaj publikut.



Treguesi i parë:	Publikimi i Programit të Transparencës të AP	Treguesi i nëntë:	Koordinatori për të drejtën e informimit
Treguesi i dytë:	Struktura/Organigrama e AP	Treguesi i dhjetë:	Raportet monitorimi/auditimi
Treguesi i tretë:	Struktura e pagave të AP	Treguesi i njëmbëdhjetë:	Buxheti 2025
Treguesi i katërt:	Funksionet dhe detyrat e AP	Treguesi i dymbëdhjetë:	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik 2025
Treguesi i pestë:	Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime/Vendimmarja	Treguesi i trembëdhjetë:	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik 2025
Treguesi i gjashtë:	CV e titullarit të AP	Treguesi i katërbëdhjetë:	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025
Treguesi i shtatë:	Legjislacioni kombëtar	Treguesi i pesëmbëdhjetë:	Lista e shërbimeve që ofron AP
Treguesi i tetë:	Rregullore e brendshme për funksionimin e AP	Treguesi i gjashtëmbëdhjetë:	Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes

Treguesi i parë:	Publikimi i Programit të Transparencës	Treguesi i nëntë:	Koordinatori për të drejtën e informimit
Treguesi i dytë:	Struktura/Organigrama	Treguesi i dhjetë:	Raportet monitorimi/auditimi KLSH
Treguesi i tretë:	Struktura e pagave	Treguesi i njëmbëdhjetë:	PBA 2025-2027/Buxheti 2025
Treguesi i katërt:	Funksionet e NJVV	Treguesi i dymbëdhjetë:	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8 maj 2025
Treguesi i pestë:	Publikimi i vendimeve të NJVV	Treguesi i trembëdhjetë:	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025
Treguesi i gjashtë:	CV e titullarit	Treguesi i katërbëdhjetë:	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025
Treguesi i shtatë:	Legjislacioni kombëtar	Treguesi i pesëmbëdhjetë:	Lista e shërbimeve që ofron NJVV
Treguesi i tetë:	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e NJVV	Treguesi i gjashtëmbëdhjetë:	Publikimi i informacionit mbi "Të dhënat e koordinatori për nevojimin dhe konsultimin publik" NJVV

Procesi i monitorimit është mbështetur në kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, me qëllim garantimin e aksesit sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës në informacionin dhe dokumentacionin me karakter publik. Për realizimin e këtij vlerësimi janë përdorur 16 tregues monitorimi, nga 12 tregues të përdorur për vitin 2024. Ky ushtrim i përvitshëm synon jo vetëm evidentimin e problematikave dhe sfidave, por edhe identifikimin dhe promovimin e praktikave të konsoliduara pozitive, ku transparenca proaktive trajtohet si një standard i përditshëm i funksionimit institucional.

Nga analiza krahasimore rezultojnë një përmirësim i vazhdueshëm i nivelit të transparencës proaktive nga viti në vit, duke marrë në konsideratë si rritjen e numrit të treguesve të vlerësimit, ashtu edhe zgjerimin e numrit të autoriteteve të monitoruara. Megjithatë, mbetet e domosdoshme ruajtja e nivelit të lartë të angazhimit institucional dhe forcimi i përgjegjshmërisë profesionale për adresimin e sfidave të evidentuara gjatë procesit të monitorimit. Zyra e Komisionerit rithekson se çdo përpjekje për konsolidimin e mekanizmave të transparencës është e mirëpritur, duke theksuar parimin themelor se hapja përbën "rregullin", ndërsa kufizimet përbëjnë "përjashtimin".

Transparenca dhe mbrojtja e të dhënave, Komisioneri Dervishi takim me Administratoren e IdentiTek

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Në fokus të bisedës ishte roli i IdentiTek, si shoqëri Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, publike që administron dhe zhvillon sistemet e priti në një takim Administratoren e re të IdentiTek, identifikimit elektronik dhe shërbimet digjitale të znj. Silda Çepe. Gjatë takimit u diskutua mbi lidhura me to, duke përpunuar një volum të rëndësishëm e forcimit të bashkëpunimit konsiderueshëm të dhënash personale. Në këtë ndërinstitucional, si një hap i domosdoshëm për kuadër, u theksua nevoja për përputhshmëri të plotë garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale si me standardet ligjore dhe praktikat më të mira në dhe rritjen e transparencës dhe besimit të fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qytetarëve.



Komisioneri Besnik Dervishi vlerësoi angazhimin e IdentiTek në këto drejtime dhe garantoi mbështetjen dhe bashkëpunimin e institucionit që drejton, në funksion të forcimit të standardeve të së drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Vendimmarrja e Komisionerit

[Vendim Nr. 09, datë 05.03.2026](#), për urdhërimin e autoritetit publik Universiteti i Tiranës për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

[Vendim Nr. 10, datë 05.03.2026](#), për rrëzimin e ankesës ndaj shoqërisë “Integrated Energy BV SPV”.

[Vendim Nr. 11, datë 10.03.2026](#), për urdhërimin e autoritetit publik Korporata e Investimeve Shqiptare për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Vizitë studimore në Slloveni për zbatimin e ligjit për të dhënat e hapura



Zyra e Komisionerit, në vijim të bashkëpunimit me TAIEX, zhvilloi një vizitë studimore në Slloveni, me fokus zbatimin efektiv të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me praktikat më të mira të institucioneve sllovene në zbatimin e kuadrit rregullator dhe shkëmbimin e eksperiencave ndërinstitucionale në këtë fushë.

Gjatë kësaj vizite dy ditore, përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit zhvilluan takime me kolegë nga autoriteti

homolog dhe nga Ministria për Administratën Publike, në të cilat u prezantuan raste praktike mbi trajtimin e kërkesave për ripërdorim të informacionit, procedurat e ankimit, si dhe përvoja konkrete të bazuara në praktikat e Bashkimit Evropian. Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua edhe çështjeve që lidhen me ripërdorimin e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë shembuj praktikë mbi përdorimin e të dhënave dinamike. Gjithashtu, u diskutua mbi rolin e Ministrisë në monitorimin dhe mbikëqyrjen e organeve publike për zbatimin e legjislacionit të kësaj fushe, funksionimin e portalit qendror “Open Data” në Slloveni dhe mënyrat e ndërveprimit të tij me ripërdoruesit.





Në kuadër të vizitës studimore u prezantua edhe eksperiencia e bashkëpunimit me Universitetin e Administratës Publike për përgatitjen dhe publikimin e të dhënave të hapura, si dhe raste konkrete të ripërdorimit të këtyre të dhënave për zhvillimin e aplikacioneve dhe shërbimeve inovative. Përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit përfituan njohuri mbi praktikat më të mira në fushën e të dhënave të hapura dhe diskutuan me ekspertët sllovenë për përafrimin e standardeve shqiptare me ato evropiane. Bashkëpunimi dhe mbështetja e ofruar nga TAIEX dhe institucionet partnere në Slloveni, do t'i shërbejnë Zyrës së Komisionerit në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirëssimit të monitorimit dhe mbikëqyrjes për zbatimin efektiv të ligjit nr. 33/2022.

Trajnim me koordinatorët për forcimin e transparencës dhe aksesit në informacion

Në vijim të veprimtarisë për garantimin dhe promovimin e të drejtës për informim, Zyra e Komisionerit po intensifikon përpjekjet për rritjen e kapaciteteve profesionale të koordinatorëve mbi kuadrin rregullator të fushës. Me këtë qëllim, u zhvillua një trajnim online me koordinatorët e caktuar/ndryshuar rishtazi nga rreth 30 autoritete publike, duke synuar fuqizimin e rolit të tyre në optikën e zbatimit praktik të legjislacionit për aksesin në informacionin me karakter publik.

Gjatë trajnimit, u trajtuan në mënyrë të detajuar detyrimet ligjore që lidhen me garantimin e së drejtës për informim, me theks të veçantë në publikimin dhe përditësimin e Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Një vëmendje e posaçme iu kushtua edhe përdorimit të Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve (REKPMI), përmes portalit pyetshtetin.al, si një instrument kyç për rritjen e transparencës dhe efikasitetit institucional.

Nëpërmjet një qasjeje interaktive, të bazuar në pyetje dhe diskutime konkrete, pjesëmarrësit u njohën me praktikën më të mirë dhe mënyrat efektive të zbatimit të legjislacionit në përditshmëri. Zyra e Komisionerit, në përpunim me Programin vjetor të Punës, do të vijojë organizimin e trajnimeve periodike, duke kontribuar në forcimin e kulturës së transparencës dhe rritjen e llogaridhënies së autoriteteve publike ndaj qytetarëve apo grupeve të interesit.





Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:



Konferenca XVII, përgatitjet për takimin vjetor të ICIC

Komiteti i Planifikimit për përgatitjen e Konferencës së 17-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) zhvilloi mbledhjen e katërt, nën drejtimin e Zyrës së Komisionerit në cilësinë e Presidencës dhe Sekretariatit të organizatës. Takimi vjetor i ICIC mbahet në Sierra Leone, në datat 28-30 shtator 2026.

Gjatë kësaj mbledhje, anëtarët e Komitetit diskutuan mbi përbajtjen e Konferencës, me fokus të veçantë te tematikat për sesionet plenare dhe ato të paneleve specifike, që ndërlidhen me të drejtën për akses në informacion publik. Komentet dhe sugjerimet mbi strukturën e propozuar të programit do të qarkullojnë në një hapësirë të dedikuar online, për t'u integruar në versionin përfundimtar, që pritet të miratohet së shpejti nga Komiteti Ekzekutiv i ICIC. Po ashtu, në këtë mbledhje u trajtuan edhe çështjet që lidhen me aspektet tekniko-organizative dhe logjistikën, ku i gjithë informacioni i domosdoshëm do të jetë i publikuar në faqen e dedikuar në internet të Konferencës.



Në kuadër të përgatitjeve për Konferencën e 17-të të ICIC, u zhvillua edhe një takim me karakter teknik, me pjesëmarrjen e Zyrës së Komisionerit, autoritetit të Sierra Leones si vend organizator, atij të Afrikës së Jugut, si dhe partnerëve nga UNESCO dhe organizata kanadeze “Qendra për ligj dhe demokraci”. Ky takim punë shërbeu për të saktësuar dhe dakordësuar disa çështje për sa i përket harmonizimit të agjendës së sesionit të hapur, për përfshirjen e sa më shumë kontributorëve në këtë Konferencë.

* Ky podcast u zhvillua nga Shoqata Together for Life në kuadër të projektit “Përbalja me dezinformimin shëndetësor & deepfake në epokën e inteligjencës artificiale”, me mbështetjen e See Check dhe financimin e Bashkimit Evropian. Përgjegjësia për përbajtjen i takon vetëm Together for Life dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.

#FakteJoMite #Dezinformimi #Shendet #DataProtection #Deepfake #MediaLiteracy #TogetherForLife



Zyra e Komisionerit ishte e ftuar në Podcastin e organizatës “Together for Life” mbi dezinformimin shëndetësor dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në epokën digjitale. Në episodin e dytë të podcastit #FakteJoMite, për të kuptuar si të mbrojmë veten, të dhënat tona dhe të marrim vendime të informuara për shëndetin.